

VENDIM
Nr. 385, datë 25.5.2016

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E TATIMEVE TEK AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA) TË MJEDISEVE TË PRONËS “NDËRTESE -
TRUALL”, ME NR. PASURIE 3/703, LAGJJA NR. 1, KRUIË, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 818, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të katit të parë dhe të një sipërfaqeje prej 30 (tridhjetë) m² e katit të dytë të ndërtesës, me numër pasurie 3/703, zona kadastrale 8621, lagjja nr. 1, Krujë, me sipërfaqe totale 330.2 (treqind e tridhjetë pikë dy) m², për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Prona me numër rendor 30, me emërtimin “Ndërtesë”, lagjja nr. 1, Krujë, hiqet nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave.

3. Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe kryeregjistruesi Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

